



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.132

22 shtator

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.586, datë 3.8.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.59, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të shoqërisë së informacionit”	5955
Vendim i KM nr.590, datë, 18.8.2011	Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve jonizuese”	5972
Vendim i KM nr.591, datë 18.8.2011	Për miratimin e rregullores “Për nivelet e lejuara të përqendrimit të radonit në ndërtesa dhe ujë, nivelet udhëzuese të radiobërthamave në materialet e ndërtimit, si dhe nivelet e lejuara të radiobërthamave në ushqime dhe produkte kozmetike”	5980
Vendim i KM nr.628, datë 7.9.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.55, datë 26.1.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2011, në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.....	5983

VENDIM
Nr.586, datë 3.8.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.59, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË SHOQËRISË
SË INFORMACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Aneksi 2, “Plani i veprimit” (SNSSHI), bashkëlidhur vendimit nr.59, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me aneksin që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANI I VEPRIMIT (SNSSHI) 2011-2013

Aktivitetet		Përshkrimi i aktivitetit	Institucionet përgjegjëse	Treguesit monitorues	Afati i realizimit		
I.		Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit					
I.	1		Zhvillimi i rrjeteve NGN, shfrytëzimi efektiv i spektrit të frekuencave, dhënia në përdorim e frekuencave për shërbimet me brez të gjerë	MITIK/AKEP	2011-2013		
I.	2		Miratimi i dokumentit të politikës për zhvillimin e shërbimeve në brez të gjerë	MITIK	Internet më i shpejtë, internet me çmime më të lira	2011	
I.	3		Amendimi i ligjit 9918 me direktivat e fundit të BE-së	MITIK	Rritja e përdoruesve të internetit	2011	
I.	4	Rrjetet e komunikimeve elektronike	Plotësimi i kuadrit rregullator në përputhje me direktivat BE-së, përfshirë kuadrin rregullator për NGA, WLR, WBA	AKEP	Përqindja e personave që kanë akses interneti në shtëpi	Përqindja e përdoruesve familjarë apo individëve me akses <i>broadband</i> në internet	2011-2013
I.	6		Rritja e konkurrencës në qarkun lokal, Implementimi i aksesit të hapur në qarkun lokal (ULL)	AKEP	Çmimet e aksesit në internet, e ndarë sipas zonave dhe teknologjisë së përdorur	2011-2013	
I.	7		Reduktimi i tarifave për linjat me qira përmes rritjes së konkurrencës dhe zbatimin e kuadrit rregullator	AKEP	Rritja e përqindjes së penetrimit të <i>broadband</i>	2011-2013	
I.	8		Krijimi i skemave të financimit publik, kur është e nevojshme dhe pa dëmtuar konkurrencën, për mbështetjen e zhvillimit të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe mbështetjen e projekteve të zhvillimit sidomos në	MITIK		2011-2013	

			zonat më pak të favorizuara			
I.	9		Mbështetje e operatorëve dhe industrisë për kalimin në IPV6	MITIK/AKEP		2011-2012
I.	10	Infrastruktura TIK në administratën publike	Zhvillimi, zgjerimi i rrjetit	AKSHI	Rritja e numrit të institucioneve të lidhura në <i>govnet</i>	
I.	11		Ofrimi i aksesit internet me brez të gjerë për administratën publike. Rritja e <i>bandwidthit</i> të ofruar për administratën publike, kapaciteti minimal 100 Mbit/s për administratën qendrore	AKSHI	Rritja e numrit të përdoruesve të rrjetit <i>govnet</i>	
I.	12		Ofrimi i shërbimeve të përqendruara për administratën publike si internet, <i>mail</i> , <i>security</i> , <i>web hosting</i>	AKSHI	Përqindja e punonjësve që përdorin kompjuterë me lidhje interneti në punën e tyre të përditshme	
I.	13		Krijimi i platformës unike të administratës qendrore	AKSHI/ML	Përqindja e institucioneve të administratës publike me akses <i>broadband</i> me shpejtësi të lartë.	
I.	14		Ndërtimi i qendrës së të dhënave për qeverinë shqiptare	MITIK/AKSHI	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara për publikun	
I.	15		Krijimi i <i>Government Gateway</i> dhe sistemit të menaxhimit të dokumenteve	MITIK/AKSHI		
I.	16		Kompjuterizimi i plotë i sistemit të akreditimit duke përfshirë pajisje të reja, server, krijimin e rrjetit dhe trajnimin e personelit	METE/DPA		
I.	17					
II.		Zhvillimi i qeverisjes elektronike dhe i shërbimeve publike				
II.	1		Krijimi i bazës së të dhënave për burimet natyrore dhe aktivitetit minerar, ofrimi i shërbimit <i>online</i> (AKBN)	METE	Përmirësimi i cilësisë së shërbimit Rritja e transparencës	2010-2013

					Rritja e efektivitetit në punën e administratës publike	
II.	2	Krijimi i bazave të të dhënave elektronike	Zhvillimi i sistemit të menaxhimit financiar AFMIS (MoF): Zhvillimi, zgjerimi i sistemit të thesarit me MTPB, PIM, EAMIS dhe IPSIS	MF/DEBASKON/ AKSHI	Rritja e efektivitetit në punën e administratës publike	2011
II.	3		Krijimi dhe zhvillimi i sistemit të informacionit për bazën e të dhënave për menaxhimin e standardeve, krijimi i infrastrukturës TIK për DBS-në	METE/DPS/AKSHI	Rritja e indeksit të pjesëmarrjes elektronike	2010-2011
II.	4		Implementimi i një baze të të dhënave mbi punësimin	MPCSSHB/AKSHI	Rritja e indeksit të gatishmërisë së qeverisjes elektronike	2011-2012
II.	5		Regjistri kombëtar i automjeteve	MPPT/AKSHI		2010-2011
II.	6		Digjitalizimi i arkivave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe menaxhimit të dokumenteve (DPT)	MF/AKSHI		2012 - 2013
II.	7		Ngritja e bazës së të dhënave të pensioneve (lidhja <i>online</i> e pensioneve) Ngritja e arkivës digjitale të ISSH-së Ruajtja digjitale e materialeve të pensioneve dhe kontributeve të ISSH-së	MF/ISSH/AKSHI		2011-2012
II.	8		Zhvillimi i bazës së të dhënave elektronike të Qendrës së Publikimeve Zyrtare	QPZ/AKSHI		2011
II.	9			Zhvillimi i aplikacionit të bazuar në <i>web</i> EMIS, Baza e të dhënave të mësuesve, amza digjitale	MASH	
II.	10	Institucion më pak shkresa	Projektimi dhe implementimi i një sistemi të menaxhimit të dokumenteve për një ministri	AKSHI	Rritja e efektivitetit në punën e administratës publike	2011-2013
	11		Shtrirja e këtij sistemi në 5 institucione të tjera	AKSHI	Rritja e cilësisë së shërbimit për shërbimet e ofruara ndaj publikut	2012
	12		Shtrirja e këtij sistemi në të gjithë administratën qendrore	AKSHI	Reduktimi i kostove të punës	2013
II.	13	Arkiva digjitale	Projektimi dhe implementimi i një sistemi elektronik për arkivimin digjital	AKSHI/DPA	Lehtësimi i procesit të aksesimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike	2013

	14		Shtrirja e këtij sistemi në 5 institucione të tjera	AKSHI/ML	për qytetarët dhe biznesin	2012
	15		Shtrirja e këtij sistemi në të gjithë administratën qendrore	AKSHI/ML	Rritja e treguesit për e-pjesëmarrjen Rritja e transparencës	2013
II.	16	e-kabinet	Zgjerimi dhe përmirësimi i sistemit të e-kabinetit	Këshilli i Ministrave, AKSHI		2011
II.	17	e-parlamenti	Krijimi i sistemit elektronik për kuvendin	AKSHI/Kuvendi		2011-2012
III.	Shërbimet publike					
III.	1	e-portali	Zhvillimi, përmirësimi i portalit www.e-Albania.al .	AKSHI/ML		2011-2012
III.	2	e-punësimi	Kompletimi i procesit të informatizimit të tregut të punës në gjithë sistemin e shërbimit publik të punësimit; Zhvillimi i mëtejshëm dhe shtrirja e programit pilot të informatizimit të shërbimeve të punësimit të zbatuar në zyrat rajonale Tiranë dhe Korçë në të gjithë sistemin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Ofrimi i shërbimit <i>online</i> të kërkimit për punë në të gjithë vendin	MPCSSHB	Rritja e cilësisë së shërbimit për shërbimet e ofruara ndaj publikut Rritja e % së shërbimeve të ofruara në mënyrë interaktive	2011-2013
III.	3		Publikimi nëpërmjet faqes së internetit www.kerkojpunë.gov.al të vendeve të lira të punës të mbledhura nga zyrat rajonale të punësimit	MPCSSHB	Rritja e transparencës, thjeshtimi i procedurave të punësimit	2011-2013
III.	4	e-punësimi	Krijimi i një regjistri elektronik kombëtar për punëkërkuesit dhe vendet e lira të punës, si dhe pajisja me mjete të TIK-ut e gjithë sistemit të zyrave të punës në Shqipëri	MPCSSHB		2011-2012

III.	5		Rikompozimi dhe përfundimi i faqes së DPSHB-së brenda <i>web-site</i> të MPCSSH-së në shqip dhe në anglisht, si dhe përditësimi i materialeve dhe informacioneve më të fundit mbi mekanizmin institucional për barazinë gjinore, dhe dhunën në familje, si dhe informacione të ndryshme në këto fusha. www.mpcs.gov.al/dpsbh	MPCSSHB		2011
III.	6		Digjitalizimi i skemës së ndihmës ekonomike dhe fillimi i ofrimit të shërbimeve interaktive	MPCSSHB/AKSHI		2011-2013
III.	7	e-sigurime shoqërore	Implementimi i një sistemi elektronik për Institutin e Sigurimeve Shoqërore	MF/ISSH	Përmirësimi i cilësisë së shërbimit	2011
III.	8		Përmirësimi i infrastrukturës TIK të ISSH-së përmes ngritjes së rrjetit, dhomës së serverave dhe ndërtimi i një infrastrukture me shtresë fibre optike, implementimi i një sistemi menaxhimi të dokumenteve	MF/ISSH	Reduktimi i kostove Rritja e indeksit të gatishmërisë elektronike	2011-2013
III.	9		Automatizimi i sistemit të brendshëm financiar të ISSH-së	MF/ISSH	Rritja e transparencës	2011-2012
III.	10	Lejet e lidhura me mjedisin	Ofrimi i shërbimit të licencimit online	QKL/MM	Rritja e % së shërbimeve të ofruara plotësisht online	2011-2013
III.	11	e-patenta	Aplikimi elektronik për patentën dhe marrjen e një shërbimi të shpejtë	MPPT/AKSHI	Kalimi në ofrimin e shërbimit online interaktiv	2011-2012
III.	12	Deklarimi në polici	Ofrimi i shërbimit të deklarimit në polici nëpërmjet një aplikacioni në faqen <i>web</i>	MB	Rritja e % së shërbimeve të ofruara <i>online</i>	2011
III.	13	e-gjoha	Krijimi, zhvillimi i një sistemi të centralizuar elektronik për administrimin dhe menaxhimin e gjobave	MB/MPPT	Rritja e cilësisë së shërbimit për qytetarin Rritja e efektivitetit në punën e administratës	2011-2012
III.	14	R.K.GJ.C	Shfrytëzimi i RKGjC-së për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave të gjendjes civile të shtetasve dhe plotësimin e lëshimit në format elektronik të certifikatave dhe akteve të tjera që mban ky shërbim. Digjitalizimi i regjistrave themeltarë të arkivuar (aktet dhe regjistrat themeltarë të zyrave të gjendjes civile në degët e qarkut)	MB/Organet e Qeverisjes Vendore	Rritja e % së shërbimeve të ofruara <i>online</i>	2013

III.	15		Zhvillimi i projektit për identifikimin online të përdoruesve të shërbimeve elektronike përmes letërnjoftimit	MB	Rritja e shkallës së sofistikimit për shërbimet e qeverisjes elektronike	2013	
III.	16	R.K.A	Krijimi dhe përdorimi i sistemit të adresave. Implementimi i sistemit të adresave dhe ndryshimi i tyre sipas kërkesave të ligjit për sistemin e adresave dhe lidhja e RKA-së (Regjistri Kombëtar i Adresave) me RKGJC-në	MB/AKSHI/ Pushteti Lokal	Rritja e % së shërbimeve të ofrura <i>online</i>	2011-2013	
III.	17	Numri 112	Numri i emergjencës 112, kryerja e një studimi fizibiliteti për implementimin e numrit 112	MB/MITIK	Krijimi i një hapësire të harmonizuar europiane për shërbimet e emergjencës civile	2011 e në vijim	
III.	18	e-shëndetësia	Hartimi i një strategjie për implementimin e e-shëndetësisë në nivel kombëtar	MSH/MITIK	Planifikim më i mirë i ndërhyrjeve dhe investimeve të nevojshme në fushën e digjitalizimit të shëndetësisë Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe menaxhimit të burimeve Reduktim i ndjeshëm i kohës dhe kostos së shpenzuar në proceset e përditshme. Rritja e cilësisë së të dhënave përmirësimi i analizës së tyre dhe rritja e transparencës	2011	
III.	19		Informatizimi i sistemit të informacionit në QSUT, në mbështetje të projekteve kombëtare për kërkim dhe zhvillim	MSH		2010-2011	
III.	20		Implementimi i një <i>software-i</i> , obsetrik gjinekologjik, në maternitete	MSH		2011-2013	
III.	21		Krijimi i një sistemi <i>data warehouse</i> për Institutin e Shëndetit Publik	MSH		2011	
III.	22		Zhvillimi dhe implementimi i sistemit të informacionit për Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) përfshirë kartat shëndetësore	MSH/ISKSH		2011-2013	
III.	23		Krijimi i një faqeje <i>web</i> dedikuar kujdesit shëndetësor me mundësinë e këshillimit përmes komunikimit elektronik	MSH		Rritja e % së shërbimeve ofruar online duke bërë të mundur rritjen e aksesit në kujdesin shëndetësor Rritja e produktivitetit të sektorit	2013

					shëndetësor, përmirësimi i kostos dhe efikasitetit, përmirësimi i qasjes në kujdesin shëndetësor, fuqizim dhe rritje e sigurisë së pacienteve	
III.	24		Krijimi, zhvillimi i Sistemit të Integruar të Informacionit Shëndetësor (S.I.I.SH) (kredia austriake)	MITIK/MSH		2011-2013
III.	25	e-drejtesia	Hartimi i një planveprimi për identifikimin e ndërhyrjeve strategjike në sistemin e drejtësisë në fushën e ICT	MD	Numri i shërbimeve publike, totalisht të aksesueshme <i>online</i> Përmirësimi i transparencës dhe cilësisë së shërbimit ndaj publikut dhe aksesit <i>online</i> Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit nga administrata gjyqësore përmes ofrimit të shërbimeve <i>online</i> për publikun Rritja e përgjegjshmërisë Rritja e efektivitetit, cilësisë së shërbimeve përmirësimi i punës	2011/B?
	26		e-gjykata, përmirësimi i sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore	MD		2011-2013
	27		e-përmbartimi, përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të ri elektronik të menaxhimit të çështjeve përmbartimore	MD		2011-2013
	28		e-kadastra, implementimi i një sistemi elektronik për ZRPP-në me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve si dhe rritjen e transparencës (kredia austriake)	MITIK/MD/ZRPP/AKSH I		2012-2013/?
	29		E-avokatura, implementimi i një sistemi elektronik të menaxhimit të çështjeve të proceduara nga Avokatura e Shtetit	MD		2012
	30		Regjistri i ri elektronik të menaxhimit të çështjeve të sistemit peritencial (BURGJET)	MD		2012-2013
	31		Kartela elektronike mjeko-ligjore bashkëgjitur regjistrimi audio-video pranë institutit të Mjekësisë Ligjore	MD		2011-2012
	32		Regjistri i ri elektronik i menaxhimit të çështjeve të shërbimit të provës.	MD		2012-2013
	33		e-prona, implementimi i një sistemi elektronik për Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj ish-pronarëve dhe qytetarëve si dhe rritjen e transparencës	MD		2012
	34		Digjitalizimi i arkivave të Sistemit Gjyqësor Shqiptar dhe menaxhimit të tyre në kuptimin administrativ, funksional dhe si pasuri teorike	MD		2011-2014

III.	35		e-noteria së bashku me profesionet e lira pjesë e sistemit të drejtësisë shqiptare, implementimi i një sistemi elektronik të menaxhimit të çështjeve të proceduara nga noteria në veçanti dhe profesionet e lira në përgjithësi	MD		2011-2013	
III.	36	e-taksa	Zhvillimi dhe zgjerimi i sistemit të deklarimit dhe pagesave <i>online</i> për çdo tatimpagues (DPT)	MF	Rritja e shkallës së shërbimeve të ofruara plotësisht në mënyrë interaktive	2011 – 2013 Proces i vijueshëm	
	37		Ngritja e sistemit të deklarimit të të ardhurave personale për çdo tatimpagues duke nisur me miratimin e formatit të deklarimit sipas kërkesave të ligjit për deklarim (DPT)	MF		2011 – 2013	
	38		Zhvillimi i infrastrukturës së TIK-ut (DPT). Nga ndryshimet ligjore dhe nevojave në zhvillim	MF		Rritja e shkallës së përdorimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike	2011 – 2013
III.	39		Zhvillimi i shërbimeve <i>m-service</i> (DPT)	MF		Rritja e transparencës në administratën tatimore	2012
	40		Modernizimi i shërbimit ndaj tatimpaguesve duke e përshtatur me zhvillimin teknologjik (DPT)	MF		Rritja e efencës në ofrimin e shërbimeve të taksave	2013
	41		Blerja dhe implementimi i sistemit të ri tatimor (CORE System) (DPT) (kredia austriake)	MITIK/MF/DPT/ AKSHI			2011- 2013
III.	42	e-dogana	Zhvillimi dhe implementimi i sistemit të informatizuar për akcizën	MF/DPD	Sistemi automatik i përpunimit të të dhënave	2011-2013	
	43		Përmirësimi i sistemit <i>Asycuda World</i> dhe sistemit të transitit në përputhje me praktikën e BE-së	MF/DPD	Përmirësimi i cilësisë së shërbimit për përdoruesit	2011-2013	
	44		Zhvillimi i sistemit të pagesave <i>online</i> për doganat	MF/DPD	Rritja e transparencës dhe efencës së punës në sistemin doganor	2011-2013	
III.	45	Shëndeti dhe siguria në punë	Krijimi i një sistemi modern kombëtar të teknologjisë së informacionit për inspektimin në punë. Sigurimi i një sistemi për informimin dhe komunikimin e inspektoratit të punës me ndihmën e	MPCSSHB	Përmirësimi dhe rritja e efencës së shërbimeve të inspektimit Përmirësimi i nivelit të shërbimit, ndaj punëkërkesve,	2012	

			kompjuterizimit		dhe punëdhënësve		
III.	46	e-thesari	Zgjerim i sistemit të thesarit në 50 institucione buxhetore	MF	Zhvillimi i shërbimeve <i>online</i> qeveri –qeveri	2011 – 2013	
	47		Sistem për menaxhimin e komponentëve të IPA-së, zhvillimi i sistemit MIS	MF		2011 – 2012	
	48		Rehabilitimi i MSC-së dhe BCC-së të MF-së	MF		2011	
	49		Sistem për menaxhimin e borxhit publik (MoF)	MF		2011 – 2012	
III.	50	e-statistika	Aplikimi <i>online</i> për anketën tremujore	INSTAT	Monitorimi i zhvillimit të shoqërisë së informacionit	2012	
	51		Tregues mbi përdorimin e internetit në 11 mijë biznese	INSTAT		2011	
	52		Tregues mbi përdorimin e internetit në 3600 familje anketa e matjes së nivelit të jetesës pranë familjeve (LSMS)	INSTAT		Vlerësimi i efektivitetit të politikave për zhvillimin e shoqërisë së informacionit	2011-2012
	53		Ndërtimi i faqes dinamike të <i>ueb-it</i> Është duke u ndërtuar faqja e re dinamike e <i>webit</i> , e cila do t'i lejojë përdoruesit të navigojnë dhe <i>download</i> statistikën sipas formateve të ndryshme	INSTAT		Rritja e % të shërbimeve publike të ofruar <i>online</i>	2011
	54		Anketat vjetore ICT pranë ndërmarrjeve	INSTAT		Rritja e shkallës së pjesëmarrjes dhe transparencës me publikun	2012
III.	55	Bibliotekat virtuale	Ofrimi i informacionit bibliotekar për fondin e bibliotekës përmes katalogut elektronik. Ofrimi i përmbajtjes së disa periodikëve në formë elektronike	MTRKS	Nr. i kartelave dhe nr. i vizitorëve	2012	
III.	56	e-turizmi	Zhvillimi i faqes së internetit <i>www.albantourism.com</i> , si një faqe promovuese e turizmit shqiptar me informacion shumëgjuhësh të vlefshëm për turistët dhe operatorët turistik. Implementimi i kësaj faqe është parashikuar të kryhet brenda vitit 2011	MTRKS	Përmirësimi i shërbimeve për turizmin	2011	

III.	57		Krijimi i <i>Tourism Satellite Account</i> Krijimi i një kuadri (modeli) për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore në terren në lidhje me mallrat dhe shërbimet turistike. Ky sistem siguron të dhëna të qëndrueshme, të besueshme dhe të krahasueshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për analizën e tregut turistik. Është një projekt i nisur dhe parashikohet të përfundojë brenda vitit 2011, i shtrirë vetëm në tri qytete kryesore	MTRKS	Përmirësimi i përpunimit të të dhënave statistikore për turizmin si një mekanizëm për një planifikim më të mirë, menaxhim dhe zhvillim të sektorit të turizmit	2011
III.	58	e -kulturë	Katalogimi elektronik i një pjese të konsiderueshme të objekteve kulturore dhe dalja e tyre në internet për konsultim nga publiku	MTRKS		2011-2013
	59		Harta Arkeologjike e Shqipërisë Krijimi i një <i>data baze</i> elektronike i të gjitha <i>siteve</i> (qendrave) arkeologjike në territorin e Shqipërisë duke përdorur teknika bashkëkohore duke vendosur në këtë sistem edhe hartat kadastrale, hartat topografike, zonifikimet arkeologjike, monumentet e kulturës dhe zonat e mbrojtura përreth tyre	MTRKS/AKSHI	Përmirësimi i përpunimit të të dhënave duke kaluar nga një sistem fragmentar të mbledhjes së të dhënave në një sistem të ri të unifikuar të dhënat e të cilit do të jenë rezultat i një kërkimi të integruar në terren, arkiva, institucione dhe fusha të ndryshme	2013
III.	60	- GIS	- Krijimi i një kornize të plotë ligjore e cila do mundësojë modernizimin e NSDI-së (National Spatial Data Infrastructure) në përputhje të plotë me direktivën e KE-së, INSPIRE. Korniza ligjore do jetë produkt i një konsulence të përzgjedhur dhe të financuar nga UNDP-ja, sipas termave të referencës të përgatitura nga DEDAL dhe GNIP-ja ngritur me urdhër të Kryeministrit. Infrastruktura do mundësojë krijimin e një reference unike me standardet e pranuar nga BE-ja për të gjitha gjeodatat e përdorura në sistemet e informacionit të ndërtuara apo që do ndërtohen në vend	MITIK		2011
III.	61	Transporti rrugor	- Zhvillimi i sistemeve inteligjente të transportit rrugor; - Përmirësimi i sistemit të informimit të	MPPT/MB/MSH etj.	Rritja e sigurisë në transportin rrugor Ulja e numrit të aksidenteve	2011 e në vijim

			aksidenteve, SIA; - Kryerja e një studimi fizibiliteti për mënyrën e lidhjes midis institucioneve		Rritja e efikasitetit të punës së institucioneve në shërbim të qytetarit	
IV.		Edukimi dhe përhapja e njohurive				
IV	1	e-edukim Infrastruktura TIK	Përmirësimi i infrastrukturës TIK në arsim: - Rritja e shpejtësisë së aksesit internet në shkolla dhe cilësisë së shërbimit; - Shtimi i laboratorëve të informatikës; - Pajisja me laptopë e mësuesve të informatikës; - Pajisja me laptopë dhe projektorë e klasave të sistemit parauniversitar; - Pajisja me laboratorë për mësimin e gjuhëve të huaja; - Pilotimi i teknologjive arsimore në disa shkolla		Numri i nxënësve për kompjuter të lidhur në internet (të përdorur për qëllime trajnimi), të ndarë sipas tipit të institucionit arsimor dhe vendndodhjes gjeografike	2009
IV	2		Aplikimi <i>online</i> për sistemin universitar	MASH		2011-2012
IV	3	e-edukimi Integrimi i TIK në mësimdhënie/mësimnxënie	- Hartimi i planit për integrimin e TIK-ut në sistemin arsimor 2011-2013; - Ndarja e planit me grupet e interesuara; - Implementimi i rekomandimeve të “Planit të integritit të TIK-ut në arsim 2011-2013”; - Trajnimi i mësuesve të sistemit të arsimit parauniversitar në integrimin e TIK-ut në kurrikula; - Trajnimi i mësuesve të sistemit të arsimit parauniversitar në integrimin e TIK-ut në kurrikula nëpërmjet të mësuarit bazuar në projekte; - Ngritja e qendrës kombëtare të testimeve TIK-ut (certifikatat ECDL), Tiranë, Shkodër, Vlorë, Korçë; - Ngritja e qendrës kombëtare të trajnimeve TIK (ECDL)	MASH	Numri i nxënësve/studentëve për një kompjuter, të ndarë sipas tipit të institucionit arsimor dhe vendndodhjes gjeografike Numri i nxënësve për kompjuter të lidhur në internet, të ndarë sipas tipit të institucionit arsimor dhe vendndodhjes gjeografike	2011-2013 2011-2013

IV	4	e-edukimi TIK kurrikula	Implementimi i kurrikulës së re të rishikuar TIK për klasat 1-12: <ul style="list-style-type: none"> - Rishikimi i kurrikulës ekzistuese; - Rekomandimi i kurrikulës së re TIK klasat 1-12; - Paraqitja e kurrikulës te grupet e interesit/marrja e <i>inputeve</i>; - Reflektimi i <i>inputeve</i> në kurrikulën e re; - Ngritja e grupeve të trajnimit për kurrikulën e re 	MASH	Rritja e shkallës së përdorimit të TIK-ut në shkolla Përmirësimi i indeksit të gatishmërisë elektronike	2011-2013
IV	5	e-edukimi Standardet për TIK	Përcaktimi i skemave/standardeve të përgatitjes/certifikimit të specialistit të teknologjisë në edukim: <ul style="list-style-type: none"> - Ngritja e grupit të punës për përcaktimin e standardeve të specialistit të teknologjisë në edukim; - Përcaktimi i skemave të përgatitjes/kurrikulës/certifikimit të specialistit të teknologjisë në edukim; - Bashkëpunimi me IAL-të për përgatitjen e specialistit të teknologjisë në edukim; - Bashkëpunimi me institucionet trajnuese private për përgatitjen e specialistit të teknologjisë në edukim 	MASH	Përmirësimi i mësimdhënies përmes TIK-ut	2011-2013
IV	6	e-edukimi Zhvillimi i përmbajtjes <i>online</i>	Biblioteka digjitale: <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e termave të referencës për bibliotekën digjitale; - Zhvillimi i aplikacionit të bibliotekës digjitale; - Pasurimi me përmbajtje kurrikulare, ndihmëse interaktive <i>online</i>; - Pasurimi me <i>software</i> edukativë për mësimdhënien 	MASH	Përmirësimi i mësimdhënies përmes TIK-ut	2011 2011 2011-2013
V. Zvogëlimi i ndarjes digjitale						

V	1	TIK për të gjithë	Hartimi i politikave përfshirëse në shoqërinë e informacionit, një plani veprimi “Shoqëri informacioni për të gjithë”	MITIK/MASH/MPCSH B		2011-2012
V	2		Përshtatja e kuadrit të duhur ligjor dhe standardeve në përputhje me parimet e aksesimit. Implementimi i standardeve ndërkombëtare për <i>e-accessibility</i> /WACG/Web 2.0	MITIK / AKSHI ML	Rritja e indeksit të gatishmërisë elektronike Rritja e indeksit të pjesëmarrjes elektronike	2011-2013
V	3		Projektimi i faqeve <i>web</i> sipas praktikave më të mira për të lehtësuar aksesimin në informacion, dhe përhapjen e njohurive në veçanti për personat me aftësi të kufizuara	MITIK / AKSHI/MPCSSHB	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve Rritja e numrit të qytetarëve që përdorin TIK -un	2011-2013
V	4		Lançimi i një programi për pasurimin e përmbajtjes <i>online</i> në gjuhën shqipe dhe pasurimi i faqeve zyrtare në <i>web</i> me informacion në gjuhë të huaj (anglisht/italisht/gjuhë të tjera të rajonit)	MITIK / AKSHI/ML	Rritja e numrit të qytetarëve që përdorin shërbimet publike <i>online</i> Rritja e shkallës së njohurive	2011-2013
V	5		Projekt pilot për rritjen e aksesit për TIK-un implementimi i “e-book reader” si projekt pilot në disa shkolla në zona të ndryshme të vendit, më pak të favorizuara	MASH	Përmirësimi i qeverisjes në nivel lokal	2011-2013
V	6		Përhapja e njohurive: Implementimi i moduleve me përmbajtje trajnimesh që mund të përdoren lokalisht në laboratorët kompjuterikë të shkollave ose për zhvillimin e trajnimeve <i>online</i>	MASH	Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë Rritja e shkallës së përdorimit të internetit dhe shërbimeve të qeverisjes elektronike në zonat e PAP	2011-2013
V	7		Përcaktimi i skemës për të maksimalizuar përdorimin e laboratorëve kompjuterikë në shkolla për komunitetin: - zgjatja e orarit të shfrytëzimit; - përdorimi i laboratorëve TIK në shkolla në fundjavë	MASH	Përmirësimi i qeverisjes lokale përmes TIK-ut	2011-2013
V	8		Zhvillimi dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve të qeverisjes elektronike në PAP, të zyrave postare	MITIK/Posta Shqiptare	Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë	2011-2013

V	9		Organizimi i aktiviteteve për rritjen e njohurive në lidhje me përdorimin e TIK-ut	MITIK/AKSHI		2011-2013
V	10		Qeverisja elektronike në nivel lokal: Ndërgjegjësimi i nivelit të dytë të pushtetit lokal mbi qeverisjen elektronike (e-Gov) përmes një sërë aktiviteteve Përmirësimi i situatës aktuale si dhe standardizimi i <i>website-ve</i> zyrtare, konform rregullores së AKSHI-t, vendimit të Këshilli të Ministrave përkatës dhe respektimi i strategjisë TIK	MB/AKSHI		2011-2012
VI. Nxitja e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit nga biznesi						
VI	1	e-biznesi	Ngritja e qendrës së inovacionit për biznesin.	MITIK/AKSHI/ (METE/AIDA/BRIC)	Përqindja e ndërmarrjeve/bizneseve që përdorin internet Përqindja e bizneseve që përdorin tregtinë elektronike Përmirësimi i klimës së biznesit Rritja e % së shërbimeve plotësisht interaktive	2011-2012
VI	2		Implementimi i SBA	METE/ML		2011-2013
VI	3		Promovimi i zhvillimit të tregtisë elektronike: nxitja e hartimit të kodeve të etikës çështje të zhvillimit të e-biznesit të bëhen pjesë e agjendës së KKB-së	METE/ KKB MITIK/ AKEP		2011-2013 Proces i vijueshëm
VI	4		Regjistrimi i një kompanie të re: - Kalimi në ofrimin plotësisht <i>online</i> të regjistrimit të kompanisë	METE/QKR/AKSHI/MB		2011-2013
VI	5		Implementimi i strategjisë për pronësinë intelektuale në fushën e shoqërisë së informacionit	METE/DPMP ZSHDA/MB		2011-2013 Proces i vijueshëm
VI	6		Pjesëmarrje në programet CIP për inovacionin në biznes përmes TIK-ut	METE/MITIK		2011-2013
VII. SHOQËRI INFORMACIONI MË E SIGURTË						
VII	1		Hartimi i një politike kombëtare për mbrojtjen nga krimi kibernetik		Rritja e sigurisë në shoqërinë e informacionit	

VII	2	Internet më i sigurtë	Krijimi i ALCIRT-së	KM		2011/2012
VII	3		Krijimi i skemës <i>Disaster recovery</i>	AKSHI		2011-2013
VII	4		Rritja e sigurisë në komunikimet elektronike në administratën publike	AKSHI/ML		2011-2013
VII	5	Internet më i sigurtë	Ndërgjegjësimi ndaj rrezikut të krimit kibernetik, për të cilin do të angazhohen në aktivitete të ndryshme për: <ul style="list-style-type: none"> - Bashkëpunimin ndërinstitucional midis strukturave të ndryshme të teknologjisë së informacionit për sensibilizimin e grupeve të interesit dhe parandalimin e rreziqeve të tyre; - Mbikëqyrjen dhe filtrimin e informacionit të shpërndarë për parandalimin e rreziqeve që mund të sjellë informacioni nga interneti 	MB/MITIK/ AKSHI/MASH/ AKEP	Rritja e besimit për përdoruesin për përdorimin e shërbimeve <i>online</i> dhe internetin Rritja e shkallës së përdorimit të qeverisjes elektronike	2011 e në vijim
VII	6		Pasqyrimi i praktikave më të mira në faqen për mbrojtjen e fëmijëve në internet dhe zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese në bashkëpunim me NGO-në	MPCSSHB/MASH/...	Rritja e njohurive për internet më të sigurtë dhe “media literature”	2011
VII	7	Ndërgjegjësimi për sigurinë në internet	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërgjegjësimi i nxënësve, mësuesve, prindërve ndaj rritjes së sigurisë kur fëmijët përdorin mjetet e teknologjisë së komunikimit dhe informacionit; - Filtrimi i përmbajtjes së papërshtatshme për rrjetin e shkollave nga ISP-ja; - Organizimi i aktivitetit “Siguria e Fëmijëve kur janë <i>online</i>” në bashkëpunim me <i>Microsoft Albania</i>; - Promovimi i masave të sigurisë kur fëmijët janë <i>online</i> në <i>websites</i> e MASH-it; - Organizimi i një Konference mbarë kombëtare për rritjen e ndërgjegjësimit në grupet e interesit; 	MASH/MITIK/ ISP	Zhvillimi i “Media Literature” Rritja e ndërgjegjësimit për përfitimet dhe rreziqet nga interneti	2011-2013

			<ul style="list-style-type: none"> - Nxjerrja e një udhëzimi për shkollat si të veprohet për mbrojtjen e fëmijëve kur janë <i>online</i>; <p>Kurrikula e klasës së III-të TIK-ut duhet të fokusohet në rritjen e ndërgjegjësimit të fëmijëve në lidhje me përdorimin e mjeteve TIK dhe <i>www</i>;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Blerja e licencave të kurrikulës “I-Safe” për përdorimin e saj në të gjitha kurrikulat TIK për klasat III-XII 			
VIII. Përmirësimi i legjislacionit për shoqërinë e informacionit						
VIII	1	Korniza ligjore dhe nënligjore	<p>Hartimi dhe aprovimi i disa ligjeve në fushën e TIK-ut:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Legjislacioni për komunikimet elektronike në përputhje me <i>acquis</i>; - Plotësimi i kuadrit ligjor për interoperabilitetin; - Plotësimi i kuadrit ligjor me dispozita për aksesin e kushtëzuar; - Plotësimi i kuadrit nënligjor për dokumentin elektronik dhe bazat e të dhënave shtetërore; - Rishikimi i ligjit për tregtinë elektronike; - Hartimi i legjislacionit për personat me aftësi të kufizuar në përputhje me konventën e UN-së (ligj integral për personat me aftësi të kufizuar); - Propozim dhe miratim i ligjit të ri mbi të drejtat e autorit brenda 2011 	MITIK/METE/ AKSHI	Shkalla e harmonizimit me <i>Aquis Comunitaire</i>	2011-2013 Proces i vijueshëm

Shtojcë 1

Lista e shkurtimeve të reja të përdorura në Planin e Rishikuar të Veprimit

Shkurtime	Emri i plotë
ML	Ministritë e Linjës
KM	Këshilli i Ministrave
DPA tek aktiviteti I.16	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
MTPB	Midterm Planning Budget (Planifikimi Buxhetor Afatmesëm)
PIM	
EAMIS	External Assistance Management Information System (Sistemi i informacionit për menaxhimin e asistencës së huaj)
IPSIS	Integrated Planning System Information System (Sistemi i informacionit të sistemit të integruar të planifikimit)
DPS	Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve
DBS	Data Base e Standardeve (Bazë e të dhënave për standardet)
QPZ	Qendra e Publikimeve Zyrtare
DPA tek aktiviteti II.13	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
MITIK	Ministër për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit
MD	Ministria e Drejtësisë

VENDIM

Nr.590, datë 18.8.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE TË EKSPOZUAR PROFESIONALISHT NDAJ RREZATIMEVE JONIZUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” dhe të pikës 3 të nenit 42 të ligjit nr.10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për mbrojtjen e punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve jonizuese”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE

PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE TË EKSPOZUAR PROFESIONALISHT NDAJ RREZATIMEVE JONIZUESE

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore përcakton elementet bazë të sigurisë dhe shëndetit në punë të punëmarrësve të ekspozuar ndaj rrezatimeve jonizuese.

Neni 2

Detyrimet e përgjithshme të punëdhënësve

1. Punëdhënësit e licencuar për veprimtari dhe praktika që përmbajnë ekspozime normale ose ekspozime potenciale janë përgjegjës për:

a) mbrojtjen e punëmarrësve nga ekspozimet profesionale;

b) përmbushjen e çdo kërkesë të legjislacionit dhe standardeve të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese, të miratuara nga Këshilli i Ministrave ose Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR).

2. Punëdhënësit, kanë përgjegjësinë kryesore në veprimtarinë dhe praktikën me burime të rrezatimit jonizues.

3. Punëdhënësit, zbatojnë kërkesat e standardeve të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese për çdo ekspozim profesional, nga çdo burim natyror ose artificial.

4. Punëdhënësit, kanë detyrimin të plotësojnë për punëmarrësin e përfshirë në veprimtari që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë ekspozime profesionale, këto kërkesa:

a) të përcaktojnë ekspozimet profesionale të kufizuara, sipas legjislacionit në fuqi;

b) të sigurojnë mbrojtjen e punëmarrësve në të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me kërkesat themelore të standardeve të mbrojtjes nga rrezatimi jonizues;

c) të vendosin në vendin e punës dhe dokumentohen nëpërmjet një procesverballi që mbahet ndërmjet palëve, vendimet apo udhëzimet që lidhen me masat për mbrojtjen dhe sigurinë profesionale;

d) të marrin të gjitha masat për sigurimin e instalimeve të përshtatshme, sigurimin e pajisjeve dhe shërbimeve për mbrojtjen dhe sigurinë, natyra dhe shtrirja e të cilave të jenë në përputhje me vlerën e pritshme dhe të mundshme për ekspozimin profesional, duke iu drejtuar edhe personave ose shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes apo institucionit, sipas legjislacionit në fuqi;

e) të marrin masa për sigurimin e shërbimit mjekësor në punë dhe të kontrollit shëndetësor;

f) të sigurojnë pajisjet e nevojshme mbrojtëse dhe pajisjet monitoruese, si dhe instruksionin për përdorimin e tyre;

g) të sigurojnë burimet njerëzore të përshtatshme dhe trajnimet e duhura për mbrojtjen dhe sigurinë e shëndetit në punë për të arritur nivelin e duhur të njohurive;

h) të mbajnë dokumentacionin përkatës sikurse kërkohet nga standardet.

5. Punëdhënësit u sigurojnë punëmarrësve të ekspozuar ndaj burimeve të ndryshme nga ato natyrore që nuk janë të lidhur me punën e tyre ose nuk kërkohen nga puna e tyre, të kenë të njëjtin nivel mbrojtjeje si pjesë e popullatës së zakonshme.

6. Punëdhënësit, përpara punësimit të punëmarrësve, t'u kërkojnë historikun e mëparshme të ekspozimit të tyre dhe informacione të tjera të nevojshme për të siguruar mbrojtjen dhe sigurinë në përputhje me standardet e mbrojtjes nga rrezatimi jonizues.

7. Nëse punëmarrësit janë punësuar në punë që përfshijnë një burim që nuk është nën kontrollin e punëdhënësit, atëherë duhet të merret në konsideratë dhe ekspozimi shtesë.

8. Punëdhënësit, duhet të ndërmarrin veprime administrative të nevojshme që sigurojnë se punëmarrësit janë informuar, që mbrojtja dhe siguria janë pjesë integrale e programit të përgjithshëm të sigurisë dhe shëndetit profesional, në të cilin ata kanë disa detyrime dhe përgjegjësi për mbrojtjen e tyre dhe mbrojtjen e personave të tjerë ndaj rrezatimit dhe për sigurinë e burimeve.

9. Punëdhënësit, duhet të lehtësojnë përmbushjen e kërkesave të standardeve të mbrojtjes nga rrezatimi jonizues nga ana e punëmarrësve.

Neni 3

Detyrimet e punëmarrësve

1. Punëmarrësit që janë të përfshirë në veprimtari që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë ekspozime profesionale duhet:

a) të ndjekin çdo rregull dhe procedurë për mbrojtjen dhe sigurinë të përcaktuar nga punëdhënësi;

- b) të përdorin në mënyrën e duhur instrumentet monitoruese dhe pajisjet mbrojtëse të përcaktuara nga punëdhënësi;
- c) të bashkëpunojnë me punëdhënësin lidhur me mbrojtjen, sigurinë, funksionimin e programit të vlerësimit të dozave dhe të kontrollit shëndetësor radiologjik;
- d) të vënë në dispozicion të punëdhënësit, informacionin e nevojshëm lidhur me punën e bërë në të kaluarën dhe të tashmen për sa kohë që ajo lidhet me arritjen e një mbrojtjeje dhe sigurie efektive dhe të kuptueshme për veten dhe për të tjerët;
- e) të refuzojnë çdo veprim të dhunshëm që i vendos ata ose të tjerët në situata që janë në kundërshtim me kërkesat e standardeve të mbrojtjes nga rrezatimi jonizues;
- f) të pranojnë informacione, instruksione dhe trajnime që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë për të aftësuar kryerjen e punës në përputhje me kërkesat e standardeve të mbrojtjes nga rrezatimi jonizues;
- g) nëse për një arsye të çfarëdoqshme punëmarrësi është në gjendje të identifikojë rrethana, të cilat cenojnë përmbushjen e standardeve të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese, ai duhet të njoftojë menjëherë për këto rrethana punëdhënësin;
- h) punëdhënësit duhet të mbajnë shënime për çdo raportim të marrë nga punëmarrësit që identifikon rrethana, të cilat cenojnë përmbushjen e standardeve të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme;
- i) zbatimi i standardeve të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese në asnjë mënyrë nuk nënkupton lirimin e punëdhënësve nga detyrimi për të përmbushur zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve që administrojnë rreziqet në vendet e punës, duke përfshirë rrezatimin nga burimet natyrore, të cilat nuk janë të lidhura me punën.

Neni 4

Marrëveshjet e posaçme të kompensimit

Kushtet e shërbimit të punëmarrësve duhet të jenë të pavarura nga prania e mundësisë së ekspozimit profesional. Marrëdhëniet e posaçme të kompensimit ose trajtimet e preferuara në lidhje me përfitimet në pagë ose mbulimin e sigurimeve të posaçme, orët e punës, zgjatja e lejes, ditët e pushimit ose dalja në pension nuk mund të përdoren ose të jepen në këmbim të dispozitave për masa mbrojtjeje dhe sigurie të përshtatshme për të arritur përmbushjen e kërkesave të standardeve të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese.

Neni 5

Gratë shtatzëna

1. Një punëmarrëse kur e kupton që është shtatzënë njofton punëdhënësin me qëllim që kushtet e saj të punës të mund të ndryshohen kur është e nevojshme.
2. Njoftimi i shtatzënisë nuk duhet të shihet si një arsye për pushimin e punëmarrëses nga puna, ndërkohë punëdhënësi kur është i njoftuar për shtatzëninë duhet të adaptojë kushte pune lidhur me ekspozimin e saj profesional në mënyrë që embrionit ose fetusit t'i sigurohet i njëjti nivel mbrojtjeje me atë të publikut.

Neni 6

Kushtet për punëmarrësit në moshë të mitur

1. Personat në moshën 14-16 vjeç nuk duhet të merren në punë që përfshijnë ekspozime profesionale.
2. Personat nga moshja 16 deri 18 vjeç nuk duhet të lejohen të punojnë në një zonë të kontrolluar dhe angazhohen vetëm për qëllime trajnimi.

Neni 7
Zonat e kontrolluara

1. Punëdhënësit duhet të përcaktojnë si zona të kontrolluara, çdo zonë në të cilën doza ambientale vjetore kalon 6mSv në vit dhe kërkohen ose mund të kërkohen masa të posaçme mbrojtjeje dhe sigurie për:

a) kontrollin e ekspozimeve normale ose parandalimin e përhapjes së ndotjeve gjatë kushteve normale të punës;

b) parandalimin ose kufizimin e zgjatjes së ekspozimeve potenciale.

2. Gjatë përcaktimit të zonave të kontrolluara, punëdhënësit duhet të mbajnë parasysh vlerën e ekspozimeve normale të pritshme, natyrën dhe shtrirjen e procedurave të kërkuara për mbrojtjen dhe sigurinë.

Neni 8
Detyrimi i punëdhënësve në zonat e kontrolluara

1. Punëdhënësit në zonat e kontrolluara kanë detyrim:

a) të rrethojnë zonat e kontrolluara ku doza ambientale vjetore është më e madhe se 6mSv në vit, nëpërmjet mjeteve fizike ose, aty ku nuk është e mundur me mjete të tjera të përshtatshme;

b) të kufizojnë zonën e kontrolluar nëpërmjet mjeteve që janë të përshtatshme dhe të përcaktojnë kohën e ekspozimit, kur një burim funksionon në mënyrë jo të vazhdueshme ose zhvendoset nga një vend tek një tjetër;

c) të vendosin simbolin radioaktiv paralajmërues, dhe instruksione të përshtatshme në pikat e hyrjes dhe në vende të tjera brenda zonave të kontrolluara;

d) të përcaktojnë masat e mbrojtjes dhe sigurisë profesionale duke përfshirë rregullat vendore dhe procedurat që janë të përshtatshme për zonat e kontrolluara;

e) të kufizojnë hyrjet në zonat e kontrolluara nëpërmjet procedurave administrative sikurse janë, përdorimi i lejeve të punës dhe pengesave fizike. Shkalla e kufizimeve duhet të jetë në përputhje me vlerën dhe mundësinë e ekspozimeve të pritshme;

f) të sigurojnë, sipas mundësive, në hyrje të zonave të kontrolluara:

i) pajisje dhe veshje mbrojtëse;

ii) pajisje monitoruese; dhe

iii) vend të përshtatshëm ruajtjeje për veshjet personale;

g) Të sigurojnë, sipas mundësive, dhe nevojës, që në dalje të zonave të kontrolluara të ketë:

i) pajisje për monitorimin e trupit dhe veshjeje;

ii) pajisje për monitorimin e ndotjes së çdo objekti dhe lënde që del nga zona;

iii) pajisje larëse ose dushe;

iv) ruajtje të përshtatshme për pajisjet dhe veshjet mbrojtëse të ndotura;

h) të shqyrtojë periodikisht kushtet për të përcaktuar nevojën e rishikimit të masave mbrojtëse ose dispozitave të sigurisë, ose ndryshimet në kufijtë e zonave të kontrolluara.

Neni 9
Zonat e mbikëqyrura

1. Punëdhënësit përcaktojnë si zona të mbikëqyrura ato zona që nuk janë përcaktuar si zona të kontrolluara, por në të cilat kushtet e ekspozimit profesional duhet të mbahen nën kontroll dhe doza ambientale vjetore të jetë nga 1mSv deri në 6mSv në vit), ndonëse normalisht nuk është e nevojshme marrja e masave të posaçme mbrojtëse dhe e dispozitave të sigurisë.

2. Punëdhënësit duke mbajtur parasysh natyrën dhe shtrirjen e rrezikut të rrezatimit në zonat e mbikëqyrura duhet që:

a) të kufizojnë zonën e mbikëqyrur nëpërmjet mjeteve të përshtatshme;

b) të vendosin shenjat e miratuara të rrezikut radioaktiv në pikat e hyrjes së zonave të mbikëqyrura;

c) të shqyrtojnë periodikisht kushtet për të përcaktuar nevojën e rishikimit të masave mbrojtëse dhe dispozitave të sigurisë në kufijtë e zonave të mbikëqyrura.

Neni 10

Rregullat lokale dhe mbikëqyrja

1. Punëdhënësit në konsultim me punëmarrësit, sipas legjislacionit në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë, duhet:

a) të përcaktojnë me shkrim rregulla dhe procedura lokale, protokolle, që janë të nevojshme për të siguruar një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes dhe sigurisë për punëmarrësit dhe për persona të tjerë;

b) të përfshijnë në rregullat dhe procedurat lokale vlerat e çdo niveli investigues ose niveli të autorizuar dhe ndjekjen e procedurave në rastin e tejkalimit të këtyre vlerave;

c) të bëjnë të njohur rregullat dhe procedurat lokale, si dhe masat mbrojtëse dhe dispozitat e sigurisë, punëmarrësve ndaj të cilëve ato zbatohen, si dhe personave të tjerë që mund të ndikohen prej tyre;

d) të sigurojnë që çdo veprimtari e cila përmban ekspozime profesionale, të mbikëqyret në mënyrë të përshtatshme dhe të ndërmerren të gjitha hapat e nevojshëm për sigurimin e zbatimit të rregullave, procedurave, masave mbrojtëse dhe dispozitave të sigurisë;

e) të caktojnë një person përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet.

2. Punëdhënësit, duhet:

a) të vlerësojnë rreziqet për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, duke pasur parasysh natyrën e veprimtarive të ndërmarrjes/institucionit, përfshirë përzgjedhjen e pajisjeve, të substancave ose preparateve kimike dhe mënyrën e rregullimit të vendeve të punës dhe të informojë punëmarrësin për rezultatet e vlerësimit të rrezikut, si dhe masat e ndërmarra për të siguruar shëndetin dhe mbrojtjen e punës për punëmarrësin;

b) të sigurojnë të gjithë punëmarrësve informacionin e nevojshëm për çdo rrezik shëndetësor që vjen nga ekspozimi i tyre profesional qofshin ekspozime normale ose potenciale, si dhe masat e sigurisë që duhen ndërmarrë për të kontrolluar këto rreziqe dhe për të shmangur pasojat e rrezikshme;

c) t'u sigurojnë punëmarrësve që mund të hyjnë në zonat e kontrolluara informacion të përshtatshëm për:

i) rrezikun për embrionin ose fetusin që vjen nga ekspozimet për një grua shtatzënë;

ii) rëndësinë që ka informimi i punëdhënësit nga një punëmarrëse sapo ajo të kuptojë që është shtatzënë;

iii) rrezikun që paraqet për një fëmijë latent hyrja në organizmin e nënës të lëndëve radioaktive;

d) t'u sigurojnë punëmarrësve që mund të përfshihen në një plan emergjence informacionin e përshtatshëm, instruktimin dhe trajnimin e nevojshëm;

e) të mbajnë shënime për trajnimet që u sigurohen punëmarrësve.

Neni 11

Pajisjet personale mbrojtëse

1. Punëdhënësit, duhet të sigurojnë që:

a) punëmarrësit të kenë pajisje personale mbrojtëse të përshtatshme dhe që përmbushin standardet e nevojshme dhe që përbëjnë:

i) veshje mbrojtëse;

ii) pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes, për të cilat karakteristikat mbrojtëse u janë bërë të njohura përdoruesve;

iii) përparëse dhe doreza mbrojtëse dhe mbrojtëse të organeve;

b) kur është e mundur, punëmarrësit marrin instruksione të nevojshme për përdorimin e duhur të pajisjeve mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes, duke përfshirë edhe provat për përshtatshmërinë e tyre;

c) kryerja e detyrave që kërkojnë përdorimin e pajisjeve specifike mbrojtëse duhet t'u caktohet vetëm atyre punëmarrësve, të cilët bazuar në këshillat mjekësore janë të aftë të përballojnë në mënyrë të parrezikshme sforcime të mëdha;

d) të gjitha pajisjet mbrojtëse duhet të mbahen në kushte të përshtatshme dhe kur është e mundur të testohen në intervale të rregullta kohe;

e) të mbahen pajisje të përshtatshme mbrojtëse për përdorim në rastin e ndërhyrjeve;

f) nëse përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse realizohet për çdo detyrë të dhënë, duhet të mbahet parasysh çdo ekspozim shtesë që mund të vijë nga koha e tepërt ose që mund të shoqërohet me kryerjen e detyrës gjatë përdorimit të pajisjeve mbrojtëse.

Neni 12

Bashkëpunimi ndërmjet punëdhënësit dhe një personi të tretë

1. Nëse punëmarrësit janë përfshirë në punë që përmbajnë ose mund të përmbajnë një burim që nuk është nën kontrollin e punëdhënësit por të një personi të tretë, punëdhënësi dhe personi i tretë duhet të bashkëpunojnë nëpërmjet shkëmbimit të informacionit ose me rrugë të tjera për të ndihmuar marrjen e masave mbrojtëse dhe kushtet e sigurisë.

2. Bashkëpunimi ndërmjet punëdhënësit dhe personit të tretë duhet të përfshijë kur është e mundur:

a) zhvillimin dhe përdorimin e kufizimeve specifike të ekspozimit dhe mjeteve të tjera me qëllim që masat mbrojtëse dhe kushtet e sigurisë të jenë të plota;

b) vlerësimin specifik të dozave të marra nga punëmarrësit;

c) një shpërndarje dhe dokumentim të qartë të përgjegjësive përkatëse për mbrojtjen profesionale dhe sigurinë.

Neni 13

Monitorimi individual dhe vlerësimi i ekspozimit

1. Punëdhënësit janë përgjegjës për vlerësimin e ekspozimit profesional të punëmarrësve, në bazë të monitorimit individual dhe sigurojnë matje të sakta nëpërmjet shërbimeve të përshtatshme dozimetrike të njohura nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi. Kjo njohje bazohet mbi kritere të qarta të përcaktuara nga ana e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi.

2. Për çdo punëmarrës që është punësuar normalisht në një zonë të kontrolluar, ose që në mënyrë të rastësishme punon në një zonë të kontrolluar do të ndërmerret një monitorim individual i përshtatshëm. Në rastet kur monitorimi është jo i përshtatshëm, dhe jo i besueshëm, ekspozimi profesional do të vlerësohet në bazë të rezultateve të monitorimit të vendeve të punës dhe të informacionit për vendosjen dhe zgjatjen e ekspozimit të punëmarrësit.

3. Punëmarrësit e ekspozuar profesionalisht ndahen në dy kategori A dhe B sipas ndarjes së mëposhtme:

a) Punëmarrësit e kategorisë A janë të përfshirë në veprimtaritë në të cilat është e mundur të merret një dozë efektive më e madhe se 6mSv në vit, ose një dozë ekuivalente më e madhe se 3/10 e kufirit të dozës për syrin ose ekstremitetet sipas limiteve të përcaktuara. Këta punëmarrës mbulohen me dozimetri personale dhe kontrollohen çdo dy muaj:

Aktivitetet për personat e kategorisë A janë:

i) Radiografi industriale, matja e cilësisë së saldimeve, kërkimet në industrinë e naftës;

ii) Radiologji konvencionale dhe intervencionale (radiologjia intervencionale do të kontrollohet çdo një muaj);

iii) Radioterapi dhe brakiterapi me dozë të lartë, të ulët dhe të mesme;

iv) Mjekësia bërthamore;

v) Trajtim mbetjesh radioaktive;

- vi) Transporti i materialeve radioaktive;
- vii) Kërkime shkencore sipas rastit;
- viii) Kalibrimi;
- ix) Sterilizuesit;
- x) Panorameks;
- xi) Akseleratori;
- xii) Fluoreshenca me rreze x, Spektrometria Mesbauer;
- xiii) Veprimtari me gjeneratorët neutronikë;

b. Punëmarrësit e kategorisë B janë të gjithë ata të cilët nuk përfshihen në kategorinë A. Këta punëmarrës nuk do të mbulohen me dozimetri personale. Aktivitetet për punëmarrësit e kategorisë B janë:

- i) Sonda radioaktive, matësit e niveleve të lëngjeve pasi burimi është i mbyllur pa akses për përdoruesin, densitetit dhe lagështisë së tokës, matësit në konvejer;
- ii) Përdorimet e gaskromatografit;
- iii) Radiografia dentare;
- iv) Përdorimet radioimunese;
- v) Densitometria e kockave;
- vi) Rrufepritësit;
- vii) Detektorët e tymrave;
- viii) Përdorimi i skanerëve në pikat e kontrollit për bagazhet;
- ix) Transporti dhe import-eksporti i gjeneratorëve me rreze x dhe neutronikë;
- x) Transporti i paketimeve të përjashtuara;
- xi) Kjo nuk përjashton monitorimin e vendit të punës, i cili është i detyrueshëm për rastet e veprimtarive, të cilat përfshijnë punëmarrës të kategorisë B.

4. Natyra, shpeshësia dhe saktësia e monitorimit individual do të përcaktohet si më sipër duke mbajtur parasysh vlerën dhe ndryshimet e mundshme të nivelit të ekspozimit, si dhe mundësinë dhe vlerën e ekspozimit potencial. Në raste të veçanta frekuenca përcaktohet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi.

5. Punëdhënësit sigurojnë që punëmarrësit, të cilët mund të ekspozohen ndaj ndotjeve radioaktive, duke përfshirë ata që përdorin pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes, të përcaktohen saktë dhe t'u mundësohet një monitorim i përshtatshëm në një shkallë të caktuar, në mënyrë që të tregojë efektivitetin e mbrojtjes së siguruar dhe të vlerësojë në mënyrë të përshtatshme hyrjen e lëndëve radioaktive ose dozën e pritshme.

6. Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR) mban inventarin e dozës personale për të gjithë punëmarrësit e ekspozuar profesionalisht. Këto të dhëna dërgohen pranë ZMR-së nga institucionet e njohura nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për monitorimin individual.

Neni 14

Monitorimi i vendeve të punës

1. Punëdhënësit, në bashkëpunim me punëmarrësit duhet të hartojnë, të vënë në punë dhe të verifikojnë një program për monitorimin e vendeve të punës dhe të ngarkojnë një ekspert të kualifikuar ose një përgjegjës për mbrojtjen nga rrezatimet që të kryejë monitorimin.

2. Natyra dhe shpeshësia e monitorimit të vendeve të punës duhet:

a) të jetë i mjaftueshëm për të bërë të mundur:

i) vlerësimin e kushteve radiologjike në të gjitha vendet e punës;

ii) vlerësimin e ekspozimit në zonat e kontrolluara dhe në zonat e mbikëqyrura;

b) të jetë në varësi të nivelit të dozës ekuivalente ambientale dhe përqendrimeve të aktiviteteve duke përfshirë ndryshimet e mundshme dhe vlerën, si dhe mundësinë e ekspozimeve potenciale.

3. Programi për monitorimin e vendeve të punës duhet të përcaktojë:

a) madhësitë që do të maten;

b) ku dhe kur do të kryhen matjet dhe shpeshësia e tyre;

- c) metodat dhe procedurat më të përshtatshme;
 - d) nivelet e referencës dhe veprimet që do të merren nëse ato tejkalohen.
4. Punëdhënësit duhet të mbajnë shënime të rregullta për rezultatet e monitorimit të vendeve të punës, të cilat duhet t'u bëhen të njohura punëmarrësve kur është e mundur nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

Neni 15

Kontrolli mjekësor

1. Punëdhënësit, duhet të hartojnë marrëveshje të posaçme për të realizuar një kontroll të përshtatshëm mjekësor të punëmarrësve, sipas legjislacionit në fuqi. Departamenti "Shëndeti dhe Mjedisi", pranë Institutit të Shëndetit Publik përcaktohet si institucioni, i cili do të bëjë kontroll të përshtatshëm mjekësor të punëmarrësve dhe vlerësimin e efekteve në shëndet. Ky departament do të mbajë dhe inventarin kombëtar të punëmarrësve të kontrolluar dhe dosjet përkatëse shëndetësore.

2. Kur një ose më shumë punëmarrës përfshihen në punë të ndryshme që përmbajnë ose mund të përmbajnë ekspozime, si parakusht për përfshirjen e punëmarrësve në këto veprimtari, punëdhënësit hartojnë një marrëveshje të posaçme për kontrollin mjekësor.

3. Programi i kontrollit mjekësor duhet:

- a) të bazohet në parimet e përgjithshme të shëndetit në punë;
- b) të projektohet për të vlerësuar aftësinë e vazhdueshme të punëmarrësve për detyrat që ata do të kryejnë.

Neni 16

Dokumentacioni

1. Punëdhënësit, duhet të dokumentojnë ekspozimet e çdo punëmarrësi, për të cilin vlerësohet ekspozimi profesional.

2. Nëse punëmarrësit janë përfshirë në punë të ndryshme që përmbajnë ose mund të përmbajnë një burim, u bëhen të njohura rezultatet e ekspozimeve si punëmarrësve ashtu dhe punëdhënësve.

3. Dokumentacioni duhet të përfshijë:

a) informacione për natyrën e përgjithshme të veprimtarive që përmbajnë ekspozime profesionale;

b) informacione për dozën, ekspozimet dhe hyrjen e lëndëve radioaktive në organizëm në nivelet e përcaktuara ose në nivele më të larta si dhe të dhëna për mënyrën e kryerjes së vlerësimit të dozave;

c) informacione për të dhënat e punësimit të çdo punëmarrës, dozat, ekspozimet dhe hyrjet e lëndëve radioaktive në organizëm kur një punëmarrës është ose ka qenë i ekspozuar profesionalisht si rezultat i punës së kryer në punëdhënës të ndryshëm;

d) shënime për çdo dozë, ekspozim ose hyrje të lëndëve radioaktive në organizëm si rezultat i ndërhyrjeve emergjente ose aksidenteve.

4. Punëdhënësit duhet:

- a) t'u bëjnë të njohur në çdo kohë punëmarrësve ekspozimet që ata kanë marrë gjatë punës;
- b) t'i bëjnë të njohur Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimi ekspozimet e punëmarrësve;
- c) të lehtësojnë sigurimin e kopjeve të dokumenteve për ekspozimet e punëmarrësve në rastet kur punëmarrësi ndërrohet vendin e punës;
- d) të bëjnë veprimet e nevojshme për tërheqjen e shënimeve të ekspozimeve të punëmarrësit nga regjistri shtetëror kur punëmarrësi ndërpret punën;
- e) në të gjitha rastet për pikat "a" "d" të ruajnë konfidencialitetin.

5. Nëse punëdhënësi, ndërpret veprimtaritë që përmbajnë ekspozime profesionale të punëmarrësve, duhet të bëjnë veprimet e nevojshme për tërheqjen e shënimeve për ekspozimet e punëmarrësve nga regjistri shtetëror.

6. Të dhënat e ekspozimeve për çdo punëmarrës duhet të ruhen gjatë gjithë kohës së punës

së punëmarrësit deri kur punëmarrësi mbush 75 vjeç dhe jo më pak se 30 vjet mbas largimit të punëmarrësit nga puna që përmban ekspozime profesionale.

Neni 17

Rrethanat e posaçme

1. Rrethana të posaçme janë kushtet e veçanta që miratohen nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi. Në rrethana të posaçme, duhet që çdo praktikë të jetë e justifikuar sikurse kërkohet nga standardet e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe kjo praktikë është gjithashtu e optimizuar.

2. Kur ekzistojnë rrethana të posaçme, të cilat kërkojnë ndryshimin e përkohshëm të disa kërkesave për ndryshimin e kufizimit të dozave të standardeve, punëdhënësi mund të kërkojë nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi ndryshimin e përkohshëm të tyre.

3. Asnjë ndryshim i përkohshëm në kërkesat e kufizimit të dozave nuk mund të bëhet pa miratimin e KMR.

4. Punëdhënësit për çdo kërkesë që mund të bëjnë për ndryshimin e përkohshëm të kërkesave të standardeve për kufizimin e dozave:

a) përshkruajnë rrethanat e posaçme që kërkojnë ndryshimin e përkohshëm;

b) tregojnë në mënyrë të qartë se:

i) janë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për zvogëlimin e ekspozimeve, se masat mbrojtëse dhe të sigurisë janë optimizuar në përputhje me kërkesat e standardeve të mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese;

ii) punëdhënësit dhe punëmarrësit, janë konsultuar dhe është marrë miratimi i tyre për nevojën dhe kushtet e ndryshimit të përkohshëm;

iii) janë bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të përmirësuar kushtet e punës deri në arritjen e kufizimit të dozave sipas rregulloreve në fuqi;

iv) monitorimi dhe mbajtja e shënimeve për ekspozimet e punëmarrësve janë të mjaftueshme për të treguar përmbushjen e kërkesave të rregulloreve në fuqi.

5. Çdo ndryshim i përkohshëm për kërkesat e standardeve në kufizimin e dozave:

a) të jetë në përputhje me kufizimin e dozave për rrethanat e posaçme të miratuara në rregulloret në fuqi;

b) të jetë për një periudhë kohe të kufizuar;

c) të jetë objekt shqyrtimi i përvitshëm;

d) të mos përsëritet;

e) të lidhet me zona të përcaktuara të punës.

VENDIM

Nr.591, datë 18.8.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR NIVELET E LEJUARA TË PËRQENDRIMIT TË RADONIT NË NDËRTESA DHE UJË, NIVELET UDHËZUESE TË RADIOBËRTHAMAVE NË MATERIALET E NDËRTIMIT, SI DHE NIVELET E LEJUARA TË RADIOBËRTHAMAVE NË USHQIME DHE PRODUKTE KOZMETIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për nivelet e lejuara të përqendrimit të radonit në ndërtesa dhe ujë, nivelet udhëzuese të radiobërthamave në materialet e ndërtimit, si dhe nivelet e lejuara të radiobërthamave në ushqime dhe produkte kozmetike”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR NIVELET E LEJUARA TË PËRQENDRIMIT TË RADONIT NË NDËRTESA DHE UJË,
NIVELET UDHËZUESE TË RADIOBËRTHAMAVE NË MATERIALET E NDËRTIMIT, SI
DHE NIVELET E LEJUARA TË RADIOBËRTHAMAVE NË USHQIME DHE PRODUKTET
KOZMETIKE

Neni 1

Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i niveleve të lejuara për përqendrimin e radonit në ndërtesa dhe ujë, radiobërthamave në ushqime dhe materialet e ndërtimit, si bazë për mbrojtjen e publikut, personave të ekspozuar profesionalisht, dhe mjedisit nga ekspozimi ndaj rrezatimeve jonizuese.

Neni 2

Maksimumi i lejuar i përqendrimit të radonit në ndërtesat e banimit, publike dhe vendet e punës

Në ndërtesat e reja mesatarja vjetore e përqendrimit të radonit në mjediset e brendshme duhet të jetë jo më shumë se 200 Bq/m³. Në vendet e punës në ndërtesa të reja, të cilat përdoren më shumë se 80% të kohës së punës, mesatarja vjetore e përqendrimit të radonit gjatë orëve të punës duhet të jetë jo më shumë se 200 Bq/m³.

Nëse ndërtesa e re e vendit të punës përdoret më pak se 80% të kohës së punës mesatarja vjetore e përqendrimit të radonit gjatë kohës së punës duhet të jetë jo më shumë se 400 Bq/m³.

Mesatarja vjetore e përqendrimit të radonit në mjediset e brendshme të ndërtuara përpara vitit 2000 duhet të jetë jo më shumë se 400 Bq/m³.

Neni 3

Maksimumi i lejuar i përqendrimit të radonit dhe radiobërthamave në ujin e pijshëm

1. Në ujin e pijshëm, duke përfshirë gjithë sistemin e shpërndarjes së tij, ujin e paketuar dhe ujin i cili përdoret për përgatitjen e ushqimeve, do të aplikohen këto norma të përqendrimit të radonit:

- a) Përqendrimi i radonit në ujin e pijshëm duhet të jetë jo më shumë se 100 Bq/l kur:
 - i) mesatarja ditore totale e konsumuar është mbi 10 m³ ujë;
 - ii) shërben për 50 ose më shumë persona;
 - iii) shpërndahet si pjesë e aktiviteteve industriale ushqimore ose tregtare;
- b) Përqendrimi për radiobërthamat emetuese alfa duhet të jetë jo më shumë se 0.1 Bq/l;
- c) Përqendrimi për radiobërthamat emetuese beta duhet të jetë jo më shumë se 1 Bq/l.

Neni 4

Udhëzuesi për nivelin e lejuar të indekseve të aktivitetit të radiobërthamave në materialet e ndërtimit dhe produktet e ndërtimit

1. Udhëzuesi për nivelin e lejuar të indekseve të aktivitetit të radiobërthamave në materialet

e ndërtimit dhe produktet e ndërtimit bazohet në dozën e lejuar efektive prej 1mSv në vit për publikun.

2. Materialet e ndërtimit dhe produktet e ndërtimit përdoren pa kufizim për çdo sasi, nëse indeksi i aktivitetit nuk kalon vlerën 1 sipas formulës së mëposhtme:

$$I = \frac{aRa}{300} + \frac{aTh}{200} + \frac{aK}{3000}$$

(aRa, aTh, aK janë përqendrimet e Ra-226, Th-232, K-40 në Bekerel për kilogram)

3. Materialet e ndërtimit dhe produktet e ndërtimit përdoren për ndërtimin e rrugëve dhe bankinave, nëse indeksi i aktivitetit nuk kalon vlerën 1 sipas formulës së mëposhtme.

$$I = \frac{aRa}{700} + \frac{aTh}{500} + \frac{aK}{8000} + \frac{aCs}{2000}$$

(aRa, aTh, aK, aCs janë përqendrimet e Ra-226, Th-232, K-40 dhe Cs-137 në Bekerel për kilogram)

4. Materialet e ndërtimit dhe produktet e ndërtimit përdoren për mbushje dhe nivelim, nëse indeksi i aktivitetit nuk kalon vlerën 1 sipas formulës së mëposhtme

$$I = \frac{aRa}{2000} + \frac{aTh}{1500} + \frac{aK}{20000} + \frac{aCs}{5000}$$

(aRa, aTh, aK, aCs janë përqendrimet e Ra-226, Th-232, K-40 dhe Cs-137 në Bekerel për kilogram)

5. Nivelet e mësipërme janë nivele udhëzuese, por në çdo rast dhe për çdo skenar të mundshëm lidhur me ekspozimet ndaj rrezatimeve duhet që doza efektive për publikun prej 1mSv në vit të mos kalojë.

6. Vlerësimi për nivelin e lejuar të radiobërthamave në skrape të kontrollohet bazuar në nivelin prej 1mSv në vit të dozës efektive së lejuar për publikun sipas metodikave të miratuara nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi (KMR).

Kompanitë që punojnë me shkrirjen e skrapeve duhet të sigurojnë kontroll të tyre para shkrirjes dhe në import-eksportet e tyre nga Shqipëria, si dhe të metaleve të shkrira.

Neni 5

Nivelet e lejuara për përqendrimin e radiobërthamave në ushqime dhe produktet kozmetike

1. Nivelet e lejuara do të aplikohen për ushqimet dhe produktet kozmetike që prodhohen në vend, importohen apo eksportohen. Këto nivele përfshijnë radiobërthamat kryesore për ekspozim të mundshëm të publikut.

2. Përqendrimet kufi të radiobërthamave kryesore në ushqime dhe produkte kozmetike janë:

Radiobërthamat në ushqime dhe produktet kozmetike	Ushqime të destinuara për konsum të përgjithshëm dhe produktet kozmetike Përqendrimet në kBq/kg	Qumësht dhe ushqime për fëmijë kBq/kg
Cs-134, Cs-137, Ru-103	1	1
Ru-106, Sr-89	1	1
I-131	1	0.1
Sr-90	0.1	0.1
Am-241, Pu-238, Pu-239	0.01	0.001

Neni 6

Vlerësimi i niveleve të lejuara

1. Vlerësimi i këtyre niveleve bëhet nga institucione të njohura nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi (KMR).

2. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi (KMR), përcakton kriteret për institucionet, të cilat kryejnë matjet dhe lëshojnë certifikatat përkatëse.

3. Metodika e matjeve të niveleve të lejuara miratohet nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi (KMR), me propozim të institucioneve të cilat realizojnë matjet.

4. Matjet e kryera janë subjekt i inspektimit nga ana e inspektorëve të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimi (ZMR). Inspektorët verifikojnë personat juridikë e fizikë nëse ato kanë certifikatat përkatëse në lidhje me nivelin e lejuar.

VENDIM
Nr.628, datë 7.9.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.55, DATË 26.1.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.55, datë 26.1.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2011, në njësitë e qeverisjes qendrore, bëhet 1557 veta. Shtesa prej 5 punonjësish për aparatin e Ministrisë së Drejtësisë jepet me hollësi në lidhjen nr.6 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga shpenzimet korente, të miratuara në buxhetin përkatës të institucionit, për vitin 2011.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.6

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare	Muajt
14	Ministria e Drejtësisë				
	Aparati i ministrisë	5	preperatore	8 orë/ditë	4 muaj
	Total, numri i punonjësve	5			

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 20.9.2011
Doli nga shtypi më 22.9.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 32 lekë